

VENDIM
Nr. 627, datë 24.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 116, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR STATUSIN E NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE AKTUALE QË
PËRFITOJNË STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL SIPAS LIGJIT NR. 152/2013, “PËR
NËPUNËSIN CIVIL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 67, pika 8 e 69, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e kreut IV të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në rast se për shkaqe të arsyeshme procedura nuk ka përfunduar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, DAP-i/njësia përgjegjëse ka të drejtën e shtyrjes së afatit një herë të vetme. Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014.

Përfundimisht për nëpunësit/punonjësit civilë në strukturat e Forcave të Armatosura apo institucionet e tjera të varësisë, pjesë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, afati i deklarimit të statusit të punësimit përfundon në datën 31 dhjetor 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama